

VENDIM
Nr.140, datë 1.11.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.132, DATË 22.10.2007 “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR “PËR ZBATIMIN E LIGJIT TË KONCESIONEVE, DHËNIEN ME KONCESION TË OBJEKTEVE TË NDRYSHME NË PRONËSI SHTETËRORE, KUSHTET E DHËNIES SË KËTYRE KONTRATAVE PËR PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM DHE PROCEDURAT PËR FILLIMIN E PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E TEC-IT TË VLORËS””

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e grupit parlamentar të PSD,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Albert Divjaka zëvendëson deputetin Gëzim Musabelliu në Komisionin Hetimor “Për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)